

Filluan ditët e kulturës arbëreshe në Ulqin

Letërsia arbëreshe është e papërsëritshme

Prof. Françesko Altimari theksoi se me prezantimin e kulturës arbëreshe në Ulqin filloi një etapë e re midis komuniteteve tona të lashta që kanë një rol të rëndësishëm në Evropën e re, e cila ndërtohet mbi respektin e diferencave e jo asimilimin e tyre, ndërkaq arbëreshët janë dëshmorët e kësaj tendence të re

Gjekë Gjonaj, Ulqin

Në Pallatin e Kulturës në Ulqin të mërkurën në mbrëmje filluan ditët e kulturës arbëreshe në Ulqin, të cilat mbahen në kuadër të Festivalit Veror "Skena Verore - Ulqini 2008", në organizim të komunës, respektivisht kryetarit, Gëzim Hajdinaga, i cili në fjalën e tij përshëndetëse vlerësoi se kjo mbrëmje për Ulqinin do të mbetet e shënuar. "Kjo natë dhe nata e nesërme do të jenë një fillim i mbarë që na obligon që bashkërisht të japim kontributin që të jemi sa më afër njëri tjetrit", tha Hajdinaga dhe shtoi se Ulqini është i nderuar me ardhjen e arbëreshëve, sepse me këtë rast u bashkuan vëllezërit e njëjës dhe anës tjetër të Adriatikut. Prof. Françesko Altimari theksoi se me prezantimin e

poetik të menduar, të konceptuar që mund të shërbejë si një shembull i mirë për të krijuar artin e madh. Letërsia arbëreshe, riti arbëresh, vallet arbëreshe dhe poezia gojore arbëreshe janë një shembull i jashtëzakonshëm i një ekzistence nëpër kohë, të cilat dëshmojnë pikërisht për pasurinë shpirtërore të arbëreshëve, jo për idenë e teorisë që ishte se arbëreshët e ndanë kulturën e tyre për arsye se ishin të vendosur nëpër katunde të izoluar dhe të vështira, por për shkak të ruajtjes së kësaj pasurie që ata mbanin në vete", tha Berisha. Veprat që i krijuan shkrimtarët arbëreshë të shekullit XIX, pohoi Berisha, dëshmojnë vlera kulmore, jo vetëm në letërsinë arbëreshe por edhe gjithëshqiptare, sepse pikërisht, me to u krijua baza

Populli arbëresh me identitetin e tyre

Në vazhdim të kësaj mbrëmje profesor Nikolla Skalldaferrri, studiues i njohur i muzikologjisë në Universitetin e Milanos foli për muzikën arbëreshe, për të cilën tha se ajo ka elemente që kanë ardhur nga Shqipëria, elemente polifonike dhe vegla muzikore shumë interesante siç është karramuza të cilën e përdorin dhe e ruajnë shumë arbëreshët, polifonia me dy tre zëra dhe me zëra të grave si dhe gajdet, vegël tipike eurofone që përdoret zakonisht ndër katundet arbëreshe.

Françesko Lusi, ligjërues në Universitetin e Kalabrisë, trajtoi temën "Albanologjia në rrjet - projekti B.E.S.A- Biblioteka Elektronike e siteve arbëreshe". Ai tha se në këtë rrjet janë futur fondet albanologjike të bibliotekave publike dhe private të krahinës sonë, kështu që interesuarit me një klikim në internet në veb-sajtin tonë mund të mësojnë saktësisht se ku ndodhen librat dhe cila bibliotekë i ka. Sipas tij në fazën e dytë të këtij projekti mendojnë të përfshihen jo vetëm fondet e bibliotekave arbëreshe por edhe bibliotekat e botës albanologjike në Ballkan, për ç'gjë kanë biseduar me përfaqësuesit e bibliotekave të Shqipërisë, Maqedonisë, Kosovës, Malit të Zi etj.

Të pranishmit i përshëndeti në gjuhën arbëreshe edhe kryetari i komunës së Vakaricit Aldo Marino, i cili nënvizoi se populli arbëresh si shumë popuj tjerë ndërthurë dhe themelon edhe identitetin e tyre shpreh shpeshherë me mitin dhe shtoi se arbëreshët kanë një datëlindje e cila përputhet me vdekjen e Skënderbeut. "Ne lindëm në Kalabri, në kohën kur ka vdekur Skënderbeu. Ndryshe nga popujt tjerë mitin tonë e kemi përtej detit dhe pasardhësit tonë janë nisur për një vend në dhe të huaj", theksoi jo pak i emocionuar Marino. Në gjuhën arbëreshe përshëndeti edhe Françesko Tursi, kryetar i Komunës së Pllatënit, i cili tha se ndjehet i kënaqur që ndodhet në Ulqin, në këtë qytet të bukur. Nata e parë e arbëreshëve në Ulqin u mbyll me një ekspozitë me moto "Stolitë e arta të nuseve arbëreshe" përgatitur nga Muzeu Komunal i Vakaricit, dhe të fotografive dhe vizatimeve mbi Malin e Zi dhe viset e tjera ballkanike në revistat italiane në fillim të shekullit XX, nga Komuna e Puheriut me titull "Ballkani i parë nga Italia" si dhe me dorëzimin e dhuratave kryetarit të Ulqinit. ■



Ditët e kulturës arbëreshe në Ulqin në kuadër të Festivalit Veror "Skena Verore - Ulqini 2008"

kulturës arbëreshe në Ulqin filloi një etapë e re midis komuniteteve tona të lashta që kanë një rol të rëndësishëm në Evropën e re, e cila ndërtohet mbi respektin e diferencave e jo asimilimin e tyre dhe arbëreshët janë dëshmorët e kësaj tendence të re." Mendoj se ky dialog, respektivisht prezantimi i traditës arbëreshe, që filloi sonte në Ulqin është pozitiv prandaj shpresoj se këto marrëdhënie në të ardhmen duhet t'i avancojmë edhe më tej, sepse është në të mirë të përbashkët, tha Altimari.

Anton Berisha, profesor në Universitetin e Kalabrisë, duke folur për letërsinë e sotme arbëreshe, u përpoq me pak fjalë të përmbledhë disa nga veçantit kryesore të letërsisë arbëreshe në mënyrë të veçantë të letërsisë bashkëkohore arbëreshe.

"Letërsia arbëreshe është një sublimim poetik i shprehur përmes një gjuhe të zgjedhur, përmes një mesazhi

dhe qenësia e letërsisë arbëreshe.

Sipas Berishës me "Doktrinën e krishterë" të Lekë Matrëngës fillon një letërsi, një komunikim i veçantë në gjuhën arbëreshe përtej Adriatikut, për të vijuar pastaj një varg autorësh të mëdhenj, para së gjithash priftërinj të ritit bizantin, të cilët në veprat e tyre dëshmuar se letërsia ishte ajo që përlligjte pasurinë shpirtërore dhe aftësitë e krijuesve të veçantë për të shprehur pikërisht atë botë të veçantë dhe të pasur shpirtërore që kishin arbëreshët. "Janë Nikollë Fila, Nikollë Brankati, Nikollë Keta e një varg autorësh të mëdhenj për të arritur te Jul Variboba, De Rada, Zef Skiroi, Françesk Anton Santori, Lluka Perrone, Vorea Ujko, Dushko Vetmo. Di Maxho e një varg autorësh të tjerë të cilët krijuan pa mëdyshje disa nga veprat më të rëndësishme të shkruara në gjuhën tonë", theksoi Berisha.